

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-25-8175-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i objektit të MBPZHR-së, AZHB-së dhe APK-së**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

OE "TempO-2 SH.P.K."

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mramor, Prishtinë

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 45710708

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arnit Gashi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

tempotrans01@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.11.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ky aktivitet i prokurimit titullohet **“Ndërtimi i objektit të MBPZHR-së, AZHB-së dhe APK-së”** dhe ka filluar me rastin e njoftimit për kontratë i cili është publikuar me datën 03.10.2025.

Afati për dorëzimin e tenderëve është ri caktuar që të bëhet më datën 25.11.2025.

Të pakënaqur me kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosjen e tenderit, me datë 14.11.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 17.11.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të jashtë afatshme edhe pse ajo është dorëzuar në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik andaj me që AK nuk i ka trajtuar pretendimet tona, ne po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i vlerësimit është përcaktuar të jetë **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve nuk është bërë akoma por që është ri-caktuar për datën 25.11.2025.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ N/A

Jo ☐ N/A

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Të pakënaqur me kërkesat dhe kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në dosjen e tenderit, me datë 14.11.2025 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 17.11.2025 e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të jashtë afatshme edhe pse ajo është dorëzuar në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik andaj me që AK nuk i ka trajtuar pretendimet tona, ne po i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- 1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,**
- 2. AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022,**
- 3. AK ka shkelur nenin 51 të LPP-së,**
- 4. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kriterëve kualifikuese për OE, ka vendosur kriterë kufizues të cilat shihen qartë se i'a ka përshtatur një ose disa OE të caktuar. Po ashtu, AK ka vendosur edhe kriterë tjerë diskriminues dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK-së bie ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh me nenin 27, 51 dhe 69 të LPP-së përkatësisht edhe me nenin 17 të RRPP-001/2022. Këto dispozita flasin qartë dhe i detyrojnë AK-të për mos diskriminimin e OE, për hartimin e kërkesave relevante lidhur me natyrën e lëndës si dhe flasin edhe për natyrën tjetër të kërkesave përkatësisht për hartimin e mirëfilltë të dosjes së tenderit të cilat AK i ka shkelur të gjitha.

Krejt ky mos respektim i dispozitave në fjalë konsiderohet favorizim i ndonjë OE të caktuar dhe njëkohësisht edhe diskriminim i të tjerëve e që bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së. Përpos kësaj, AK ka vendosur shumë kërkesa të panevojshme të cilat përpos që janë vështirë të arritshme, krijojnë edhe shpenzime materiale për OE ku të njëjtat, më pas do të jenë kosto për vet AK-në pasi që OE ato do të i kalkulojnë të gjitha në çmimin e tenderimit. Aplikimi i komplet kërkesave për përshtatshmëri profesionale, referenca, staf, mjete pune e sidomos ISO certifikata është në kundërshtim të plotë me praktikën e mira të prokurimit dhe ato që zbatohen rregullisht në Bashkimin Evropian.

Pikat dhe kriteret kufizues më detalisht do të përshkruajmë tek pretendimet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së dhe RRPP-001/2022 që ne pretendojmë se janë shkelur.

Mos aplikimi i kriterëve duke u bazuar në natyrën e projektit, përbën favorizim dhe në të njëjtën kohë diskriminim e që kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë hartimit të dosjes përkatësisht hartimit të kërkesave për mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka vendosur shumë kriterë kufizues e në të njëjtën kohë ka lënë shumë

kriter/elemente të rëndësishme pa i përcaktuar fare. Bazuar në këtë del që dosja e tenderit nuk është hartuar në përputhje me nenin 27 të LPP përkatësisht me nenin 17 të RRPP-001/2022. Ja si e përshkruan obligimin e AK-së në hartim të dokumenteve të tilla neni 17 i RRPP-001/2022:

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

AK nuk e ka respektuar këtë andaj konstatojmë se gjatë hartimit të dosjes së tenderit janë shkelur parimet bazë të prokurimit, neni 27 i LPP-së si dhe neni 17 i RRPP-001/2022. Detajet e shkeljeve po i cekim në vazhdim:

Në dosjen e tenderit për projektin në fjalë janë vendosur disa kërkesa të cilat duken qartë se nuk janë në përputhje me LPP dhe RRPP-001/2022, e sidomos kur e krahasojmë me natyrën e projektit, si dhe nuk janë as proporcionale me madhësinë dhe volumin e projektit duke përfshi këtu kërkesa profesionale për të cilat nuk ka fare aktivitet në projekt. Në vazhdim po i renditim të gjitha pretendimet tona rreth kriterëve kufizues dhe jo proporcionale.

1. Në dosjen e tenderit tek pika 9.1&9.2 e FDT-së lidhur Përshtatshmëria Profesionale të OE është kërkuar që përpos tjerash aplikuesit të dëshmojnë se janë të certifikuar për ISO standarde të caktuara. Ja si duket kërkesa në fjalë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
		Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se është i certifikuar me këto standarde profesionale • ISO 9001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë, • ISO 14001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit, • ISO 45001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, • ISO 3834 • ISO 50001 2018 certifikatë për Auditim të Energjisë në ndërtesa Në rast të konsorciumit, kërkohet për të gjithë anëtarët e grupit.	Dëshmitë për kërkesën nr. 1 Certifikata profesionale valide, origjinale ose e noterizuar. Certifikatat duhet ti kenë të gjitha shënimet e detajuar për verifikim. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për informacione shtesë nga Institucioni për lëshimin e këtyre Certifikatave.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me parimet e mira të prokurimit dhe proporcionalitetin e punimeve. Të kërkuar certifikim të tillë për një tender nga fusha e ndërtimit dhe atë për secilin anëtar të grupit, është në kundërshtim të plotë me nenin 70 të LPP-së si dhe në kundërshtim të plotë edhe me interpretimin e KRPP-së nr.29 i publikuar në Web faqen e Prokurimit Elektronik. Fillimisht certifikata ISO 3834 është kërkuar si e mangët sepse nuk dihet se sipas standardit të cilit vit duhet me qenë. Kodi 3834 përfshinë lloje të ndryshme të saldimeve dhe standardeve duke filluar nga shumë vite më parë që tani ato janë jashtë funksionit sidomos në vendet evropiane. Edhe sa i përket certifikatës ISO 50001 2018 konsideroj se është e panevojshme sidomos kur dihet që OE auditim por ka me zbatua projekt që vet AK e ka bërë. Në fakt këtë certifikatë duhet ta ketë mbikëqyrësi punimeve e jo punëkryesi sepse ata merren me verifikimin e standardeve të energjisë. Çka nëse projekti i AK-së nuk përputhet e standardin, kush vendos mos me realizua siç është projektuar.

Edhe kërkesa që në rast konzorciumi certifikimet e tilla duhet ti kenë të gjithë anëtarët është kriter kufizues sidomos për faktin që me deklaratat e reja për themelimin e grupit anëtarët që formojnë konzorciumin e ndajnë përgjegjësinë dhe detyrimet që i kanë në projekt. Pra nëse njëra kompani si anëtare ka me krye vetëm punën e saldimeve, pse u dashka e njëjta me pas edhe certifikatën e auditimi të energjisë e cila në këtë rast si punë do duhej mbulohej sipas kompetencës nga tjetri anëtar. Kërkesat e tilla vetëm sa e kufizojnë konkurrencën dhe nuk japin aspak dhe asnjë favoritet AK-së ku përkundër kësaj ato vetëm e rrisin koston e ndërtimit.

Me që po shihet se kërkesa e e tilla janë në kundërshtim me nenet adekuate të LPP dhe RRPP, atëherë s'kemi se si të mos mendojmë dhe theksojmë se kjo është në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së. Kjo duhet të ndryshohet andaj kërkojmë nga AK që ta aprovoj këtë pretendim dhe ta rregulloj dosjen e tenderit duke e kthyer atë në parametra normal të kërkesave ekuivalente dhe proporcionalë me lëndën.

2. Në dosjen e tenderit, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të OE është kërkuar që aplikuesit të dëshmojnë edhe përvojën dhe të shkuarën profesionale. Ja si duket kërkesa e tillë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kërkesa 2 Operatori ekonomik apo grupi i OE, duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë ndërtimore në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë - në vlerën minimale prej 9,000,000.00 euro.	Dëshmitë për kërkesën nr. 2 Lista e kontratave të realizuara të punëve ndërtimore në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje të referencave apo certifikatave, raporteve të pranimeve, nëse kontrata është e realizuar me kompani private të dëshmohen edhe me pasqyra bankare të realizuara (dëshmi bankare për pagesa). (sqarim AK mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike)
---	-----------	---	---

Kërkesa për referenca pa përcaktuar fare natyrën e punës tregon se AK ia ka përshtatur një OE të caktuar këtë projekt ku sipas kësaj kërkesë, i jepet mundësi që të aplikoj kushdo nga

OE i cili ka kryer ndërtime të kanalizimeve apo shtrim të rrugëve apo edhe ndonjë kanal ujitjeje. Pra mos përcaktimi që referencat të jenë nga natyra e projektit dhe lënia e mundësisë gjithë përfshirëse tregon se AK nuk është serioz në përzgjedhjen e një ndërtuesi të denjë pavarësisht se me disa kërkesa e ka tepruar duke kërkuar madje certifikime që nuk aplikohen fare në projekt. Nuk e kuptojmë se si AK-ja ka guximin të ja jap mundësinë për ndërtim të një objekti kaq të rëndësishëm edhe një kompanie që ka krye p.sh. vetëm punë në rregullimin e shtratit të lumenjëve, etj!

3. Në dosjen e tenderit, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të OE është kërkuar që aplikuesit të dëshmojnë edhe për stafin profesional. Ja si duket kërkesa e tillë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kërkesa 3 Operatori ekonomik duhet të dëshmoj Stafin profesiona 3.1 Menaxheri i projektit - OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. Te jete i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale) ose kompani e licencuar nga MPMS, 3.2. Menaxheri i punishtes - OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier të diplomuar ose master të ndërtimtarisë, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. Te jete i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale) ose kompani e licencuar nga MPMS, 3.3. OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier apo master të diplomuar të Arkitekturës. Kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhim profesional pas diplomimit 3.4. OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier apo master të diplomuar të ndërtimtarisë, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, 3.5. OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier të diplomuar ose master të Elektroteknikës, Drejtimi Elektroenergjetikë industriale me licencë A, Kërkohet të ketë min. 5 vit përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. 3.6. OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier të diplomuar ose master të Elektroteknikës, Drejtimi Elektronikë. Kërkohet të	Dëshmitë për kërkesën nr. 3 Dëshmitë për stafin profesional. Një pasqyrë tabelare të stafit dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesionin i kërkuar si dhe eksperiencia duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për stafin profesional të kërkuar duhet të dorëzohen këto dokumente e dëshmi - Kontratat valide kopje ose Parakontrate ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, - Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes, - Diplomat, - Certifikatat Licencat kopje (për inxhinierët që është kërkuar të kenë certifikata licenca), - CV me informatat e nevojshme sa i përket eksperiencës. Sqarim 1 - AK mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike. Sqarim 2 - Aty ku thuhet përvoja e punës, gjithmonë përvoja llogaritet për vitet pas diplomimit. Sqarim 3 - Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës (bachelor apo master) duhet diploma të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.
---	-----------	--	---

		ketë min. 5 vit përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. 3.7. OE duhet të dëshmoj se ka Një Inxhinier të diplomuar të Makinerisë – Drejtimi Teknika e Ngrohjes dhe Termoeenergjetika, sistemi 5 vjeçar ose master, min. 5 vjet provojë pune nga diplomimi. 3.8. OE duhet të dëshmoj se ka një inxhinier të diplomuar të Ndërtimit drejtimi hidroteknik sistemi 5 vjeçar ose master, kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 3.9. OE duhet të dëshmoj se ka një Inxhinier të Ndërtimit - Inxhinier i diplomuar ose Master i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv (min. 5 vjet provojë pune nga diplomimi.). 3.10. OE duhet të dëshmoj se ka një Inxhinier të Gjeodezisë – Inxhinier i Diplomuar i Gjeodezisë – ose Bachelor (min. 5 vjet provojë pune nga diplomimi), i licencuar sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës (AKK). 3.11. OE duhet të dëshmoj se ka një (1) Inxhinier i Emergjencave - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit. 3.12. OE duhet të dëshmoj se ka një Bachelor të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit. 3.13. min. njeri nga stafi te jete i certifikuar për menaxhimin e kontratave.	
--	--	--	--

Këtu fillimisht shihet se AK ka kërkuar staf profesional për punë dhe disa veprime që nuk janë fare kompetencë e OE të kontraktuar, e më pastaj shihet se me kombinimin e kriterëve rreth certifikimeve dhe rreth përvojës së shkallëzuar për stafit tregon qartë se kërkesat e tilla iu kanë përshtatur një OE të caktuar.

Mjafton të shikohet kërkesa që disa nga Inxhinierët duhet të kenë Licencën e OIRK-së të kategorisë A e disa që janë më të rëndësishmit për projektin sipas AK-së nuk u nevojitet me çka kuptohet se ky tender iu ka përshtatur ndonjë OE të caktuar. Shtrohet pyetja pse një ING duhet të ketë këtë licencë e cila absolutisht nuk e bënë atë më të veçantë nga të tjerët e sidomos kur dihet që akoma nuk është detyrim ligjorë një licencë tillë që lëshohet nga një shoqatë jo qeveritare siç është Oda e Inxhinierëve të Kosovës. Nisur nga kjo kërkojmë nga AK që kërkesat për stafin profesional të i harmonizoj me kërkesat e ligjit e jo të vendosë kriterë që aspak nuk lidhen e nevojën e projektit.

Pra kërkesat e tilla janë diskriminuese dhe si ligjërish duhet të largohet nga kjo pjesë e kërkesave.

4. Në dosjen e tenderit, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të OE është kërkuar që aplikuesit të dëshmojnë edhe për stafin teknik. Ja si duket kërkesa e tillë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kërkesa 4 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë Stafin Teknik (mbështetës) -Një listë prej së paku Min. 30 puntorë, 4.1 Minimum 1 (një) person të certifikuar diplomuar për elektroinstalues. 4.2 Minimum 2 (dy) persona të certifikuar për Saldim. 4.3 Minimum 1 (një) person të certifikuar për dhënie e ndihmës së parë. 4.4 Minimum 1 (një) person të certifikuar për zjarrfikje dhe shpëtim, 4.5 Minimum 1 (një) person teknik i ndertimtaris, 4.6 Minimum 1 (një) person të certifikuar fasader moler 4.7 Minimum 1 (një) person të certifikuar murator, 4.8 Minimum 1 (një) person të certifikuar për sistemin e dranzhimit,	Dëshmitë për kërkesën nr. 4 Dëshmitë për stafin Teknik. Një pasqyrë tabelare të punëtorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, kualifikimi i kërkuar të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për stafin teknik të kërkuar duhet të dorëzohen këto dokumente e dëshmi Kontratave valide kopje ose parakontrate ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt kopje, Sqarim 1 - AK mund të kërkojë për secilin dokument edhe dëshmi fizike.
---	-----------	---	--

Këtu shihet se kërkesa për disa profile që detyrimisht kërkohen me certifikata pa e saktësuar se çfarë niveli janë ato certifikata është komplet kriter kufizues dhe i përshtatur për një OE të caktuar. Prandaj kërkesat e tilla janë të tepërta, kufizuese dhe në të njëjtën kohë favorizuese dhe jo proporcionale me projektin në fjalë. E gjithë kjo bie ndesh plotësisht me nenin 7, 27, 51 dhe 69 të LPP-së.

5. Në dosjen e tenderit, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të OE është kërkuar që aplikuesit të dëshmojnë edhe për pajisjet. Ja si duket kërkesa e tillë:

ANEKSI. 7 LISTA E PAISJEVE / MAKINERIVE PUNUESE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim librezë, fature, DUD etj)
1	Cilindër jo-vibrues me peshë 7-13t	1		
2	Kompresor ajri me peshe min. 800 kg	2		
3	Kamion kiper me kapacitet min 10 m ³	5		
4	Ngarkues me peshe min. 29 ton	1		
5	Makine hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager me peshe min 200 kg	1		
6	Çekan hidraulik që montohet në bager me peshe min 2500 kg	1		
7	Vibrator Betoni	1		
8	Makine për lakimin e armaturës	1		
9	Makinë prerëse betonit dhe asfaltit	1		
10	Kamion kiper pesha max. 3.5 ton	1		
11	Luge ngarkuese (skip)	1		
12	Eskavator me rrota, me peshë min. 14 ton	2		
13	Eskavator me zinxhire me peshe min 43 ton	1		
14	Eskavator me zinxhire dhe me goma montuese me korp i pajisur me laser me peshë min 24.7 ton.	1		
15	Eskavator me rrota me peshë min. 6.6 ton	1		
16	Panella për ndërtim	1500 m ²		
17	Viç për ndërtim të lartë	1		
18	Skele për fasad	2000 m ²		
19	Automjete (Pick UP Candy ose të ngjajshme) për bartjen e materialit	2		

Fillimisht kompresori i kërkuar me peshë është e pakuptimët kur në rastet e tilla do duhej të ishte e rëndësishme që të kërkohej prurja(*kapaciteti*) i ajrit apo madhësia e rezervuarit të ajrit sepse kompresori atë punë ka. Pesha e kompresorit nuk përcakton kapacitetin punues andaj kërkesa e tillë është shumë e pakuptimët.

Ngjashëm AK ka vepruar edhe me kamionin kiper me max peshë 3.5 ton. Kur në kantier mundet të operoj eskavatori me peshë 14 ton, çfarë prish punë nëse kamioneta e tillë p.sh. posedon 5 ton. Pse u dashka eskavatori i ketë min. 6.6 ton, a nuk bënë ti ketë p.sh. 6.5 ton. Cila është arsyeja që kufizimi i tillë fillon nga 6.6 ton. Të ndërtosh një objekt me vlerë 8 mln dhe të kërkohej për transport të mallrave PickUp është kulmi i jo profesionalizmit dhe kufizimit të hapur të konkurrencës. Paramendo tërë ai objekt ku janë kërkuar kamion 10 ton kufizohet konkurrenca me kamioneta 3.5 ton. Kërkohej eskavator **43 ton** ndërsa në anën

tjetër kërkohet kamion transportues 3.5 ton! Pse u dashka të posedohet eskavatori me peshë 27.7 ton me laser kur ky është vetëm një ngarkues e që dihet që laseri është i nevojshëm vetëm për buldozer rrafshues dhe për grejderë. Pra po shihet se të gjitha pajisjet janë me kufizime, disa nga lart e disa nga poshtë vetëm sa për të iu përshtatur një OE të caktuar.

Pra të gjitha këto pesha që janë me diapazon shumë të ngushtë konsiderohet si kufizime dhe si të tilla duhet të largohen dhe të përshtaten natyrës së projektit.

6. Në web faqe është e publikuar edhe lista e çmimeve e cila është e përgatitur shumë thjesht ku shumica e pozicione janë gjithëpërfshirëse.

Kjo len shumë vend për manipulim dhe gabime në tenderim. Lista e tillë nuk i përgjigjet aspak projektit detal të hartuar për projektin andaj do të jetë e vështirë të përcaktohen vlerat për pozicione e sidomos do ketë probleme gjatë implementimit të projektit dhe pagesave për situacione. Disa pozicione janë kuturu(paushall) apo me komplet edhe pse aty ka një sasi të konsiderueshme të aktiviteteve ndërsa tek pozicioni i A.5.1 nuk dihet fare se cila është njësia matëse e artikullit në fjalë.

Nisur nga kjo konsiderojmë se lista e tillë duhet përditësuar dhe përshtatur me detalisht me projektin sepse ashtu do kontribuonte në realizimin efikas të projektit dhe shpenzimin më ekonomik të mjeteve finaciare të parapara për këtë projekt. Shihe listën e çmimeve si dëshmi në attach.

Pra të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale si dhe të tjera shihet se janë të hartuara jo mirë, posedojnë kufizime dhe favorizime, lënë vend për keqkuptime dhe keqpërdorime si dhe janë kritere të cilat në të njëjtën kohë bien ndesh edhe me kërkesat e nenit 69 të LPP-së. Nisur nga kjo lirisht mund të themi se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe 17 të RRPP-001/2022.

Bazuar në krejt këtë, kërkujmë nga OSHP që të e detyroj AK-në që kriteret në fjalë të i rregulloj dhe të i përshtatë me praktikën e mira të prokurimit si dhe të vendosen vetëm kërkesa proporcionale me projektin dhe natyrën e tij.

Pretendimi 3: AK ka shkelur edhe nenin 51 të LPP pasi që gjatë përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes sepse siç e sqaruam në pretendimin e mësipërm ka përcaktuar kritere dhe kërkesa jo relevante dhe jo proporcionale në krahasim me projektin fjalë. Ja si e përshkruan pika 3 e këtij neni këtë obligimin e AK-së gjatë hartimit të kriterëve në projekte të tilla:

Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Bazuar në këtë dhe në sqarimet e mësipërme shihet se AK e ka shkelur nenin 51.3 të LPP-së gjatë hartimit të kësaj dosjeje të tenderit.

Pretendimi 4: AK ka shkelur gjithashtu nenin 69 të LPP-së me rastin e përcaktimit të kërkesave lidhur me **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** pasi që ka kërkuar dëshmi që përpos që janë në kundërshtim me dy nenet e cekura, nuk janë fare proporcionale me natyrën e projektit që parashihet të realizohet përmes kësaj procedure. Sqarimet se në cilat pika është shkelur neni në fjalë janë dhënë tek pretendimi 1 dhe 2 andaj

kërkojmë që ato kërkesa të përmirësohen dhe të sillen brenda normave ligjore të përcaktuar me ligj.

Në bazë të kësaj konstatojmë se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 69 të LPP dhe si rrjedhojë gjatë hartimit të dosjes së tenderit edhe i ka shkelur ato.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP që të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE “TempO-2 SH.P.K.” lidhur me tenderin “**Ndërtimi i objektit të MBPZHR-së, AZHB-së dhe APK-së**”.

TË ANULOHET njoftimi për kontratë i **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL.** dhe lënda të kthehet në rishikim të kritereve.

AK të detyrohet që të shtyjë afatin e tenderimit, të angazhohet seriozisht në rregullimin e dosjes së tenderit dhe të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit, të vendos edhe kërkesa proporcionale me projektin e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit, procedurës si dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Dosja e Tenderit Shqip
-  3 Paramasa - faza 1
-  4 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara
-  5 Kerkese për Rishqyrtim nga TempO-2 SH.P.K. - 14.11.2025
-  6 Vendim per refuzim OE TempO-2 SHPK 17.11.2025

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*